

# RAPORT STUDIMOR

## INFORMIMI, NJOFTIMI DHE KONSULTIMI PUBLIK NGA PUSHTETI VENDOR

BASHKIA POGRADEC



RINIA PËR INTEGRIM, AKTIVIZIM DHE SENSIBILIZIM  
QERSHOR 2022

## Tabela e përmbajtjes

1. Hyrje.....	3
2. Lista e shkurtimeve .....	4
3. Profili i Bashkisë Pogradec.....	5
4. Metodologjia .....	7
5. Analizë e formave të njoftimit, informimit dhe konsultimit publik.....	8
6. Gjetjet nga anketimi me përfaqësuesit e Bashkisë Pogradec .....	11
7. Gjetjet nga anketimi me përfaqësuesit e Këshillit Bashkiak .....	19
8. Konkluzione.....	25
9. Rekomandime .....	25

## 1. Hyrje

Raporti studimor “Informimi, Njoftimi dhe Konsultimi Publik nga pushteti vendor” kryhet në kuadër të projektit “Përballja e Ofertave Politike – POP”. Ajo është një nismë e rrjetit të 12 organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga Olof Palme International Centre në kuadër të një programi të financuar nga Suedia: “Shoqëria Civile, Pjesëmarrja Qytetare, Llogaridhënia dhe Ndryshimi Social” dhe nga National Endowment for Democracy.

Gjatë vitit 2019, janë hartuar kontratat sociale për 9 bashki (Tiranë, Durrës, Shkodër, Fier, Vlorë, Kamëz, Pogradec dhe Pukë) dhe, që prej atij viti, rrjeti “Përballja e Ofertave Politike” monitoron zbatimin e tyre përmes dy projekteve që shkrihen te njëri – tjetri të financuara nga Olof Plame International Centre (OPIC) dhe National Endowment for Democracy (NED).

Në vitin 2021, Rrjeti POP u zgjerua duke shtuar edhe bashkitë Elbasan, Vau i Dejës dhe Korçë. Tre Kontrata Sociale u nënshkruan në bashkitë e mësipërme duke vijuar kështu monitorimin për zbatimin e tyre në 12 bashki. Nëpërmjet këtij projekti, Rrjeti POP synon të forcojë bashkëpunimin me qytetarët në përfshirjen e tyre në vendimmarrje në nivel vendor, duke qenë një urë lidhëse mes tyre (qytetarëve) dhe pushtetit vendor për sa i përket transparencës, llogaridhënies dhe demokracisë vendore.

Organizatrat e Rrjetit POP, gjatë periudhës maj -qershor 2022, realizuan pyetësorë me stafet përkatëse në Bashki dhe me përfaqësues të Këshillave Bashkiakë dhe përgjigjet e marra nga pyetësorët u përballën me analizën e bërë nga vetë shoqatat sa i përket gjendjes aktuale në secilën bashki, në lidhje me menyrën se si realizohet dhe mjetet e format që bashkitë përdorin për njoftimin, informimin dhe konsultimin e publikut.

Kjo analizë tregoi që bashkitë i vlerësojnë këto procese dhe përpiqen të përdorin mjete dhe forma të ndryshme për të patur qytetarët dhe qytetarët pjesë të veprimtarisë dhe vendimmarrjes së tyre, por ka dhe sfida që duhen tejkaluar e mangësi të cilat duhen përmirësuar.

Për shembull, faqet zyrtare të bashkive duhen të jenë më miqësore për publikun, regjistri i kërkesë-ankesave duhet të përditësohet vazhdimisht, programet e transparencës duhet të jenë lehtësisht të aksesueshme dhe të konsultohen me qytetarët, bashkitë duhet të përdorin një numër të konsiderueshëm mjetesh dhe formash për njoftimin dhe informimin e qytetarëve. Proceset e konsultimeve realizohen në bashkitë pjesëmarrëse, por më shumë duhet te punohet për rritjen dhe nxitjen e interesit të qytetarëve për të marrë pjesë dhe për t’u përfshirë në sa më shumë takime e dëgjesa publike, përfshirë procesin e hartimit të projekt-buxheteve.

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin të qytetarët, si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioritetëve të tyre. Përmes aktiviteteve, rrjeti synon të forcojë demokracinë shqiptare duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Është një përpjekje për të rritur hapësirat për debate publike dhe informacione të qytetarëve në lidhje me platformat e politikave nga njëra anë dhe duke i orientuar këto platforma drejt nevojave dhe përparësive të komunitetit nga ana tjetër.

Organizatrat partnere të rrjetit janë: Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim” Tiranë; Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës; Qendra Rinore Vlorë; Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Kamëz; Epoka e Re, Fier; Intelktualët e Rinj Shpresë, Shkodër; Lëvizja Rinore për

Demokraci, Pukë; Qendra Rinore për Progres, Kukës, Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim, Progradec, Gruaja në Zhvillim Korçë; Tjetër Vizion Elbasan dhe Qendra “Hapa të Lehtë”, Vau i Dejës.

## 2. Lista e shkurtimeve

BP	Buxhetimi me Pjesëmarrje
BPGJ	Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinator
KB	Këshilli Bashkiak
KKQV	Komisione Këshillimore Qytetare Vendore
GADC	Gender Alliance Development Center
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NED	National Endowment for Democracy
NJVQV	Njësi e Vetëqeverisjes Vendore
OPIC	Olof Plame International Centre
OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
QV	Qeverisje Vendore
RAT	Reforma Administrativo-Territoriale

### 3. Profili i Bashkisë Pogradec

Bashkia Pogradec shtrihet në pjesën juglindore të Shqipërisë, në anë të bregut jugperëndimor të liqenit të Ohrit (695 metra mbi nivelin e detit). Ajo kufizohet në veri me bashkinë e Prrenjasit, në juglindje me bashkinë e Pustecit, në jug me bashkinë e Maliqit dhe në perëndim me bashkinë e Gramshit. Sipërfaqja e Pogradecit është 595 km<sup>2</sup> (sipërfaqe tokësore) dhe 108.9 km<sup>2</sup> (sipërfaqe ujore) dhe ka 90,726 banorë në përbërjen e territorit të tij. Liqeni i Ohrit, i krijuar rreth 2 milion vjet më parë, është liqeni më i thellë tektonik i Ballkanit (liqeni i 7-të më i thellë në Europë), dhe mbulon në total një sipërfaqe prej rreth 358.2 km<sup>2</sup>, prej së cilës 109 km<sup>2</sup> i përkasin Bashkisë Pogradec.

Pogradeci është rrethuar nga fshatrat Tushemisht në lindje, Buçimas në juglindje, Gështenjas në jug, Verdovë në perëndim dhe Memëlisht në veriperëndim. Pogradeci është shpallur nga UNESCO si një vend i trashëgimisë natyrore dhe kulturore botërore.

#### **Qeverisja vendore**

Reforma Administrative Territoriale e ndodhur në vitin 2015, ndikoi në Bashkinë e Pogradecit duke i ndryshuar shtrirjen dhe kufijtë territorialë. Sot, Bashkia Pogradec përbëhet nga 8 njësi administrative të cilat janë: Pogradec, Udënisht, Proptisht, Trebinjë, Velçan, Dardhas, Buçimas dhe Çërravë. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 72 fshatra. Qytetit të Pogradecit dhe komunave Udënisht e Buçimas që shtrihen përgjatë Liqenit të Ohrit dhe orientohen drejt turizmit, me ndarjen e re territoriale i bashkohen dhe disa zona të thella malore.

#### **Njësitë administrative**

Emri i Njësisë	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
<b>Pogradec</b>	Qyteti Pogradec
<b>Udënisht</b>	Fshatrat; Udënisht, Memlisht, Çervenakë, Piskupat, Lin, Buqez
<b>Buçimas</b>	Fshatrat; Buçimas, Tushemisht, Peshkëpi, Gurras, Gështënjas, Remenj, Verdovë, Bahçallëk
<b>Çërrave</b>	Fshatrat; Çërravë, Blacë, Bletas, Alarup, Pretushë, Grabovicë, Nizhavec, Kodras, Leshnicë, Lumas, Qershizë
<b>Dardhas</b>	Fshatrat; Dardhas, Stropckë, Grunjas, Prenisht, Derdushë, Osnat, Lekas, Nicë, Stërkanj

<b>Trebinjë</b>	Fshatrat; Trebinjë, Çezmë e Madhe, Çezmë e Vogël, Hondisht, Selcë e Sipërme, Llëngë, Plenisht, Hoshtecë, Zemcë, Potgozhan, Malinë, Kalivaç, Pevelan, Dunicë, Guri i Bardhë
<b>Proptisht</b>	Fshatrat; Proptisht, Rodokal Sipër, Rodokal Poshtë, Homezh, Slabinjë, Somotinë, Kriçkovë, Selcë e Poshtme, Homçan, Vërri, Golik, Slatinë, Baribardhë, Selishtë, Zalltore
<b>Velçan</b>	Fshatrat; Velçan, Buzahishtë, Shpellë, Bishnicë, Jollë, Losnik, Laktesh, Senishtë

## **Demografia**

Bashkia Pogradec, sipas Regjistrit të Gjendjes Civile në vitin 2016 rezulton 90,726 banorë. Qyteti i Pogradecit, regjistron numrin më të lartë të banorëve duke përfaqësuar 41% (36842 banorë) të popullsisë së bashkisë Pogradec. Njësia Administrative në raport me popullsinë më të madhe pas qytetit të Pogradecit është Njësia Administrative-Buçimas me 17.792 banorë, ose 20% e totalit të bashkisë. Njësitë më të vogla të Bashkisë, për nga popullsia, janë Dardhas (3794 banorë – 4%), Trebinja (3 355 banorë - 4%) dhe Velçani (2 716 banorë– 3%). Përveç popullsisë banuese, sidomos në sezonin veror, sipas të dhënave të bashkisë, qyteti pothuaj pesëfishohet në popullsi nga turistët që frekuentojnë hotelet, si dhe banorët jo të përhershëm (ata të cilët kanë shtëpi të dyta në qytet por banojnë në qytete të tjera). Bashkia Pogradec ka patur një fluks të largimeve shumë të lartë por në 2 vitet e fundit ka rënë. Banorët janë larguar duke migruar për të siguruar kushte më të mira jetese e mundësi më të mira për punësim, por një pjesë e tyre vazhdon të kthehet në stinën e pranverës e të verës, për të punuar tokat. Gjithashtu, është vënë re një nivel i lartë migrimi, kryesisht nga zona rurale drejt qytetit, kjo përjashton vetëm zonat që janë afër qytetit të Pogradecit (distanca deri në 17 km larg) si fshati Lin, Udënisht, Tushemisht, Memëlisht, Starovë<sup>1</sup>.

## **Profili ekonomik**

Në qytetin e Pogradecit ushtrojnë aktivitetin 1,064 biznese në total, prej nga 925 janë biznese të vogla e të mesme (bar bufe, restorante, klinika, parukeri, mobileri, shërbime të ndryshme, etj, këto në masën 62 %) dhe 139 biznese të mëdha (shoqëri transporti, hotele, industri, Tv kabllor, etj). Bashkia e Pogradecit nuk ka një zhvillim të madh drejt sektorit të industrisë, që përfaqësohet nga prodhimet e konfeksioneve, shfrytëzimi i minierave dhe aktivitetet e Hec-eve. Referuar njësive administrative, bizneset e vogla kryesisht janë lokale-kafene, shitore, mulli me çekiç, nallban, bilardo, etj. Kurse biznese të mëdha janë TV kabllor, HEC, antena televizive, vaska peshku, miniera, kompani

<sup>1</sup> Raport Vlerësimi I Komunitetit për Qeverisjen 2019  
[https://pdf.usaid.gov/pdf\\_docs/PA00WMF1.pdf](https://pdf.usaid.gov/pdf_docs/PA00WMF1.pdf)

asfaltim/inerte, hotele etj. Vihet re se numri i bizneseve të mëdha dhe të vogla ka pasur një rënie në 5-vjeçarin e fundit. Prishja e lokaleve, restoranteve e hoteleve buzë liqenit ka ndikuar ndjeshëm në rënien e punësimit, sidomos për njësinë administrative Udënisht (rreth 200 të punësuar e të siguruar, dhe shumë më tepër të tjerë të pa siguruar) kanë mbetur pa punë. Elementë të tjerë të aktiviteteve që ndikojnë në zhvillimin ekonomik janë bujqësia, blegtoaria dhe peshkimi (vetëm për zonat që lagen nga Liqeni i Ohrit). Niveli i lartë i varfërisë, sidomos për zona të caktuara, në Bashkinë e Pogradecit konfirmohet edhe nga të dhënat që ekzistojnë për Ndihmën Ekonomike, me të cilën trajtohen familjet në nevojë. Sipas të dhënave të bashkisë janë 4,509 familje në total që trajtohet me ndihmë ekonomike.<sup>2</sup> Për disa familje kryesisht nga fshatrat përreth Pogradecit, vendi fqinj i Maqedonisë është zgjidhja për punësim ditor ose sezonal. Burrat shkojnë për të punuar në vendin fqinjë kryesisht në sektorin e ndërtimit dhe punëve të tjera të krahut. Asetet kulturore në zonë janë të shumta por pak të njohura pasi deri më tani kanë munguar politikat e promovimit. Pavarësisht fshatrave të shumta turistike buzë liqenit, turistët që vijnë janë të orientuar nga agjencitë turistike maqedonase të cilat përfshijnë në paketat turistike që ofrojnë vizitat ditore në Pogradec dhe disa nga fshatrat si Lin, Tushemisht, Volorekë, etj.

Pogradeci dhe fshatrat pranë tij, për shkak se janë kthyer në një destinacion turistik, kanë pasur një hov të sektorit të ndërtimit ku përgjatë dekadës së fundit janë ngritur dhjetra pallate shumëkatësh, duke ngritur shumë pikëpyetje lidhur me planifikimin urbanistik të zonës.

## 4. Metodologjia

Për hartimin e raportit mbi situatën e informimit, njoftimit dhe konsultimit publik në Bashkinë Pogradec janë kërkuar dhe përdorur një seri teknikash dhe instrumentash, të tilla si: a) hartimi i metodologjisë dhe instrumentit të anketimit (dy pyetësorë); b) kërkim dhe analizim të informacionit, dokumentave (fizikë dhe elektronikë) dhe kuadrit rregullator e ligjor përkatës; c) intervista të thelluara me stafin e bashkisë dhe anëtarë të Këshillit Bashkiak; d) analizim dhe përpunim të të dhënave të anketimit dhe e) përgatitja e raportit së bashku me rekomandimet përkatëse.

Ekspertët e projektit e bazuan procesin e kërkimit dhe analizimit në tërësinë e informacionit dokumentacionit dhe praktikave, të përdorura në procese të ndryshme të njoftimit, informimit, konsultimit dhe angazhimit të komunitetit në bashkëqeverisje dhe vendimarrje. Prosesi i kërkimit dhe analizimit u shtri si në dokumencionin ekzistues zyrtar, ashtu edhe në kuadrin respektiv rregullator e ligjor, të tilla si Ligji Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligji Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, Ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, etj. Identifikimi dhe analiza e burimeve

<sup>2</sup> Raport Vlerësimi I Komunitetit për Qeverisjen 2019  
[https://pdf.usaid.gov/pdf\\_docs/PA00WMF1.pdf](https://pdf.usaid.gov/pdf_docs/PA00WMF1.pdf)

ekzistuese tregoi se ka pak informacion dhe të dhëna të disonueshme mbi praktikat e përfshirjes qytetare në qeverisjen vendore.

Pamjaftueshmëria e informacionit të disponueshëm mbi çështjen në fjalë, theksoi rëndësinë e procesit të anketimit me të gjithë hallkat e veta (hartimi i metodologjisë, përcaktimi i rubrikave dhe informacionit që duhej mbledhur dhe analizuar, dhe format e mjetet që do të përdreshin për kryerjen e tij). Metoda kryesore për realizimin e studimit është ajo sasiore, që nënkupton përdorimin e pyetësorëve për mbledhjen e të dhënave. Anketimi përdori gjerësisht elemente të vlerësimit cilësor nëpërmjet pyetjeve të hapura dhe shpjeguese me qëllim eksplorimin e instrumenteve dhe proceseve që sigurojnë angazhim dhe gjithë përfshirje të komuniteteve në pushtetin vendor. Metodologjia e studimit mbart elementë të fortë të vlerësimit informativ.

Pjesë e këtij anketimit janë drejtues, stafe teknike dhe këshilltarë vendorë të 12 bashkive të madhësive të ndryshme të përfshira në programet shumë vjeçare që Olof Palme ka zbatuar në vend. Për anketimin u hartuan dy pyetësorë me pyetje shteruese cilësore dhe sasiore, të cilat mbulojnë një gamë të gjerë temash dhe çështjesh. Për përgatitjen e pyetësorëve u konsultuan paraprakisht ligjet, rregulloret dhe udhëzimet përkatëse që përbëjnë kuadrin ligjor dhe institucional mbi informimin, njoftimin dhe konsultimin qytetar në nivel vendor.

Faza përmbyllëse përfshiu hedhjen, përpunimin statistikor, studimin dhe analizimin e të dhënave, si dhe përgatitjen e këtij raportit përfundimtar.

## **5. Analizë e formave të njoftimit, informimit dhe konsultimit publik**

Për realizimin e këtij raporti u përpara paraqitjes se rezultateve të pyetësorëve të zhvilluara me përfaqësues të bashkisë dhe këshillit bashkiak u realizua një analizë e mjeteve dhe formave të njoftimit dhe konsultimit publik që realizon bashkia Pogradec.

### ***Zyra e Transparencës dhe Ankesave***

Bashkia Pogradec ka të parashikuar në rregulloren e saj dhe zyrën e transparencës dhe ankesave që mirëpret kërkesat për informacion dhe ankesat nga qytetarët. Kjo zyrë është përgjegjëse për mbarëvajtjen dhe dhënien e përgjigjeve për çdo ankesë drejtuar nga qytetarët si verbale, me shkrim apo nëpërmjet telefonit. Çdo kërkesë për informacion mbahet shënim në regjistrin përkatës dhe protokollohet, në respektim të procedurës së miratuar në rregullore.

### ***Regjistri kërkesë - ankesave***


Bashkia Pogradec krijon, mban dhe bën publik një regjistër të posaçëm, ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre. Ky regjistër



përditësohet çdo 3 muaj dhe publikohet në faqen e internetit të autoritetit publik, si dhe në mjediset e pritjes së publikut në zyrat e autoritetit publik. Identiteti i kërkuesve të informacionit nuk pasqyrohet në regjistrë. Komisioneri për të Drejtën e Informimit Publik si dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale vendos standarde për formatin dhe përmbajtjen e regjistrit.

## Faqja Web e Bashkisë Pogradec


Një tjetër formë që bashkia Pogradec ka për informimin, njoftimin e publikut është faqja web: [bashkiaprogradec.gov.al](http://bashkiaprogradec.gov.al). Kjo faqe në web është e ndërtuar më shumë mbi bazën e dhënies së informacionit në formën e shkruar dhe shikohet si një nga mënyrat e cila bashkia komunikon me qytetarët. Pamja e parë që shfaqet sapo hapim faqen janë eventet më të fundit, takime të rëndësishme të mbajtura nga kryetari i bashkisë dhe ikona që të drejtojnë tek aplikime dhe informacione. Gjithashtu, në fillim të faqes ka menu ku të drejtojnë tek informacione të tjera dhe Këshilli Bashkiak. Sapo futesh ne faqe, shikon tab “Institucioni & Administrata” ku pasi e selekton gjen informacionet për kryetarin e bashkisë, nën kryetarin, sekretarin e pergjithshem dhe stafin tjetër administrativ. Gjithashtu, gjen informacione për ndërmarrjet në varësi, drejtoritë e Bashkisë dhe legjislacionin. Website duket që ka shumë informacione për qytetarët, por mungon tab search që mund ta lehtësonte kërkimin.



## Rrjeti Social Facebook

Faqja zyrtare në facebook e bashkisë menaxhohet nga punonjësit e zyrës së medias në këtë bashki. Bashkia Pogradec në këtë faqe ka rreth 19,800 ndjekës, të cilën e përdor si një platformë tjetër komunikimi dhe informimi për qytetarët. Nga monitorimi që është bërë postimet në këtë faqe janë pothuajse 2-3 në ditë në varësi të aktiviteteve dhe me një

mesatare 5 postime në javë. Postimet janë të përbëra nga foto dhe tekst të cilat përveç informimit dhe njoftimeve gjithashtu tregojnë aktivitetet të ndryshme të bashkisë, përfundimin e projekteve të ndryshme, takime ose mbledhje si dhe promovimin e pikave të ndryshme turistike.



## Komunikimet e drejtëpërdrejta

Komunikimi i drejtëpërdrejtë realizohet nga dëgjesat publike, buxhetimi me pjesëmarrje dhe takimet nga aktivitete të ndryshme me publikun. Te gjitha këto forma të komunikimit të drejtëpërdrejtë realizohen nga bashkia në lidhje me tematika të ndryshme.



## 6. Gjetjet nga anketimi me përfaqësuesit e Bashkisë Pogradec

Të intervistuarit në Bashkinë Pogradec janë punonjës të drejtorive dhe sektorëve të ndryshëm që kanë të bëjnë me procese që lidhen me të drejtën e informimit, njoftimin, dhe konsultimin publik me qytetarët. Të anketuarit, koordinatori për informim dhe konsultim publik, administrator të njësive të ndryshme dhe përfaqësues nga sekretaria e Keshillit Bashkiak. Anketimi me përfaqësues nga Bashkia Pogradec dhe nga Këshilli Bashkiak synon të sjellë situatën aktuale në lidhje me pjesëmarrjen qytetare në procese konsultuese dhe vendimmarrëse si dhe të analizojë të gjitha format dhe mënyrat të cilat përdor institucioni në informimin e qytetarëve.

### **Rëndësia e njoftimit dhe informimit në vendimmarrjen vendore**


Në zbatim të detyrimeve të parashikuar në ligjin 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”. Në Bashkinë Pogradec të anketuarit janë pyetur mbi rëndësinë e njoftimit në vendimmarrjen vendore, duke e cilësuar të gjithë si një proces **shumë të rëndësishëm**.

Rëndësia e informimit në vendimmarrjen vendore për të gjithë punonjësitë e bashkisë vlerësohet si një proces shumë i rëndësishëm. E drejta për informim është e garantuar në përputhje me ligjin 119/2014, ku secili mund të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, insitucionet publike duhet të garantojnë transparencën dhe të drejtën e informimit për të gjithë.



## Rëndësia e konsultimit në vendimmarrjen vendore


Pjesëmarrja e publikut në vendimmarrje, është një e drejtë e qytetarëve në kuadër të qeverisjes, po ashtu përbën edhe një detyrim qytetar për të kontribuar në drejtim të një qeverisjeje të mirë. Ligji 146/2014 “Për njoftimin dhe Konsultimin publik” si dhe ligji 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, mbështesin dhe nxisin pjesëmarrjen efektive




gjithëpërfshirëse të komunitetit në qeverisjen vendore. Të anketuarit e vlerësojnë si një proces *shumë të rëndësishëm* konsultimin me publikun, po ashtu nga monitorimi Bashkia Pogradec e ka realizuar këtë proces. Për të pasur një proces efektiv konsultimi publik duhet të përmbushen tre komponentët kryesorë të tij: njoftimi konsultimi dhe pjesëmarrja.

## Njohuria mbi bazën ligjore

Njohuria mbi bazën ligjore për njoftimin, informimin dhe konsultimin në vendimmarrjen vendore, rreth 84% e të intervistuarve janë përgjigjur se e njohin **mirë** dhe 16% **shumë mirë**.




Ndërsa, mbi vlerësimin e kuadrit ligjor 84% e të intervistuarve janë shprehur se është i qartë dhe i plotë ndërsa 16% u shprehen se është i plotë por jo shumë i qartë dhe nga një nga gjërat që duhet të ndryshojë është rritja e numrit të persona përgjegjës për informimin në terren.




### **Ekzistenca e koordinitorit për njoftimin dhe konsultimin publik**

Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik, parashikohet nga dy ligje dhe një Vendim i Këshillit të Ministrave. Konkretisht, ligji 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe VKM Nr. 828, datë 7.10.2015, “Për Miratimin e Rregullave të Krijimit dhe Administrimit të Regjistrimit Elektronik për njoftimet dhe Konsultimet Publike. Koordinatorin për njoftimin dhe konsultimin publik sipas ligjit ka një rol të rëndësishëm, në procesin realizimit të njoftimeve dhe konsultimeve publike dhe me detyra të përcaktuara qartë. Të intervistuarit në bashki janë përgjegjës në masën 30% për ekzistencën e koordinitorit për konsultim publik dhe 70% janë përgjegjës që jo, ndërsa për transparencën 30% janë përgjegjës që po ka koordinatorë dhe 70% janë përgjegjës që jo.




Të dhënat e koordinitorit duhet të afishohen publikisht, në faqen zyrtare të bashkisë. Nga monitorimet e kryera në faqen zyrtare web të Bashkisë Pogradec ekziston roli i koordinitorit për informim dhe të dhënat janë të publikuara në website.



### **Mjetet që përdor Bashkia Pogradec për njoftimin e qytetarëve**



Për njoftimin e qytetarëve në lidhje me çështje të ndryshme Bashkia Pogradec duket se përdor një tërësi formash në mënyrë që informacioni të shkojë tek çdo target grup. Format e ndarjes së informacionit me qytetarët realizohen nëpërmjet; lajmërimeve publike të afishuara në ambientet e bashkisë, lajmërim në mediat audiovizive, lajmërim në mediat sociale Facebook, postë dhe postë elektronike. Sipas të anketuarve, përgjigjet e tyre rezultojnë si më poshtë:



## Regjistri Elektronik në Bashkinë Pogradec

Bashkia Pogradec krijon, mban dhe bën publik një regjistër të posaçëm, ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre. Ky regjistër përditësohet çdo 3 muaj dhe publikohet në faqen e internetit të autoritetit publik, si dhe në mjediset e pritjes së publikut në zyrat e autoritetit publik. Identiteti i kërkuësve të informacionit nuk pasqyrohet në regjistër. Ky regjistër përditësohet nga koordinatori i informimit.

Nga monitorimet në faqen web të bashkisë është i publikuar regjistri elektronik por sipas faqes për periudhën janar-dhjetor 2021 ka pasur vetëm një kërkesë për informacion ndërkohe në regjistrin e ankesave për Keshillin Bashkiak shikojmë një numër shumë të lartë kërkesash.

#	Tipi	Num. Regjistrimi	Compa	QZ. Regjistrimi	Selasti	QZ. Rilindimi	Per. Shqyrtim	Wazhësi K.B.	QZ. Zbatimi	Përgjigje MeData
1	Kërkesë	K2	Nënterë Shencare	15.06.2020	Keshilli i Bashkisë	15.06.2020	Pa	26.10.2020	28.02.2021	28.02.2021
2	Ankesë	K3	Wshtraktimi me regjistrin e bashkisë	11.06.2020	Keshilli i Bashkisë, QZ. Informacione	11.06.2020	Pa	26.10.2020	26.02.2021	26.02.2021
3	Kërkesë	K4	Nënterë Shencare	11.06.2020	Keshilli i Bashkisë, Keshilli i Bashkisë	11.06.2020	Pa	26.10.2020	26.02.2021	26.02.2021
4	Kërkesë	K5	Wregjistrimi i kërkesave të informacionit kompjuterike	25.06.2020	Keshilli i Bashkisë, QZ. Informacione, QZ. Informacione	25.06.2020	Pa	26.10.2020	26.02.2021	26.02.2021
5	Ankesë	K6	Mongesa e shqyrtimit me regjistrin e bashkisë	30.06.2020	QZ. Informacione, Keshilli i Bashkisë	30.06.2020	Pa	26.10.2020	26.02.2021	26.02.2021
6	Kërkesë	K7	Financa, bashkëpunimi me bashkinë	30.06.2020	Financa, bashkëpunimi me bashkinë	30.06.2020	Pa	26.10.2020	26.02.2021	26.02.2021


Nga anketimet e kryera rreth 100% janë në dijeni të ekzistencës së regjistrit elektronik dhe publikimit të tij online.



## Mjetet e informimit për qytetarët

Sa i përket mjeteve që përdor Bashkia Pogradec për informimin e qytetarëve, vihet re rëndësia e faqja zyrtare e bashkisë si dhe mediat sociale pasi 100% e të intervistuarve i shohin si mjete të rëndësishme për informimin e qytetarëve. Më pas si format më të përdorura për informimin e qytetarëve janë këndet e informimit pranë bashkisë (60%) dhe zyrat me një ndalesë 50%. Regjistri elektronik (30%) si detyrim ligjor për publikimin e informacioneve që lidhen me procesin e njoftimit dhe konsultimit publik si dhe bashkëpunimi me mediat lokale për ndarje informacionesh duke i parë ato si një nga platformat më të ndjekura nga qytetarët (45%). Ndërsa, materialet informuese fletëpalosje, etj, (10%) është ndër format më pak të përdorura për informimin e qytetarëve dhe botimet e bashkisë të cilat nuk janë të përdorura.

Të anketuarit janë pyetur për sfidat dhe vështirësitë që ndeshin në njoftimin dhe informimin e publikut, ato kanë shprehur se komunikimi i drejtpërdrejtë me qytetarët është shumë i rëndësishëm dhe duhet të jetë gjithmonë i thjeshtë, i strukturuar dhe i kuptueshëm.





## Aksesi i qytetarëve në dokumenta

Të anketurit janë pyetur mbi aksesin që kanë qytetarët për të marrë dokumenta apo informacione të ndryshme dhe në masën 100% ato janë përgjigjur se në Bashkinë Pogradec informacioni për qytetarët është lehtësisht i aksesueshëm. Tek zyrat me një ndalesë, është koordinatorja për të drejtën për informim që i mundëson qytetarëve për t'u njohur me informacionin publik brenda afateve dhe kushteve të përcaktuara me ligj zakonisht 10 ditë. Institucioni, po ashtu, e ka për detyrë të prodhojë dhe të publikojë informacion i cili është i thjeshtë dhe i kuptueshëm për qytetarin.



## Publikimi i akteve në faqen zyrtare

Në faqen zyrtare web të bashkisë në menunë Regjistri i Akteve janë të publikuara të gjitha aktet e miratuara nga Këshilli Bashkiak. Të intervistuarit pohojnë në masën 100% se realizohet publikimi i akteve në faqen zyrtare si dhe afishimi i tyre në vende të caktuara për çështje të ndryshme.




## Hartimi i programit të transparencës

Ligji 119/2014 detyron autoritetet publike për të përgatitur, publikuar dhe përditësuar programin e transparencës duke synuar rritjen e aksesit në informacione zyrtare. Program Transparence quhet dokumenti që përmbledh tërësinë e informacioneve që duhet të jepen në mënyrë aktive nga bashkia pa kërkesë. Programi i Transparencës

publikohet në faqen zyrtare të internetit të bashkisë në një menu të veçantë të titulluar “Programi i Transparencës” në vendet e caktuara për njoftimet publike të bashkisë dhe njësive administrative.

Të intervistuarit u shprehën në masën 100% se bashkia harton dhe publikon programin e transparencës si dhe raportet vjetore për transparencën. Nga monitorimi i kryer programi i transparencës si dhe hartimi dhe publikimi i raporteve vjetore për transparencën në vendimmarrje janë të publikuara në faqen zyrtare dhe mund të aksesohen lehtësisht (<https://bashkiapogradec.gov.al/faqe/programi-i-transaprences-11/>)

Anketuesit pohojnë se programi i transparencës përfshin numrin e akteve të miratuar nga Bashkia përgjatë vitit, numrin e përgjithshëm të rekomandimeve të marra nga palët e interesuara, numrin e rekomandimeve e të komenteve të pranuar dhe të refuzuara gjatë procesit të vendimmarrjes si dhe numrin e takimeve publike të organizuara. Gjithashtu, në programin e transparencës jepen informacione për buxhetin si kalendari i programit buxhetor afatmesëm, vështirësitë financiare, zbatimi i buxhetit etj.




### Trajnimet mbi detyrimet ligjore mbi informimin publik




Të intervistuarit janë pyetur nëse kanë marrë trajnime në lidhje me detyrimet ligjore për informimin e publikut ku rreth 90% janë përgjigjur se kanë zhvilluar trajnime të tilla dhe 10% nuk kanë marrë trajnime. Pavarësisht ato janë shprehur se ka nevojë për trajnime më shume dhe punë në terren për informimin.

## 7. Gjetjet nga anketimi me përfaqësuesit e Këshillit Bashkiak

Të intervistuarit e Këshillit Bashkiak Pogradec e vlerësojnë në masën 100% rëndësinë e njoftimit dhe informimit në vendimmarjen vendore. Njoftimi i publikut për mbledhjet e këshillit realizohet në forma të ndryshme duke e shikuar si një element shumë të rëndësishëm pjesëmarrjen e qytetarëve në procese të ndryshme konsultuese.





Mbledhjet e Këshillit Bashkiak janë një proces shumë i rëndësishëm sa i përket konsultimit publik në vendimmarjen vendore. Pjesëmarrja qytetare është një e drejtë e qytetarëve në kuadër të qeverisjes, prandaj për të pasur një proces efektiv konsultimi publik duhet të ketë pjesëmarrje.




### ***Njohuria mbi bazën ligjore për njoftimin, informimin dhe konsultimin në vendimmarrjen vendore***

Të anketuarit janë përgjigjur me 50% mirë dhe 50% disi për njohurinë që kanë mbi njoftimin dhe konsultimin në vendimmarrjen vendore dhe po kështu vlerësojnë kuadrin ligjor referues të plotë dhe të qartë, në masën 100%.




### **Vlerësimi për rregulloret e Këshillit Bashkiak**



100% e pjesëmarrësve në pyetsor i vlerësojnë rregulloret e Këshillit Bashkiak si të qarta dhe të plota. Gjithashtu, ato janë pyetur nëse do të kishte nevoja për rishikime apo plotësime cilat do të ishin rekomandimet, u shprehën se sipas tyre s'ka nevojë për asnjë përshterje dhe çdo gjë është e qartë dhe e plotë.

### **Bashkëpunimi mes Bashkisë Pogradec dhe Këshillit Bashkiak**

Të intervistuarit janë përgjigjur në masën 100% sa i përket bashkëpunimit mes Këshillit Bashkiak dhe Bashkisë Pogradec për procesin e njoftimit dhe informimit me publikun. Ky bashkëpunim realizohet nëpërmjet mënyrave të ndryshme të komunikimit duke nisur me sektorin e IT-së për publikimin e njoftimeve dhe vendimeve, nëpërmjet njoftimeve mediatike, këndeve të njoftimit si dhe asistencë për transmetimin e mbledhjeve online. Administrata sjellë projekt-vendimet, sekretari i Këshillit Bashkiak lajmeron për mbledhjen e radhës.




### Publikimi i njoftimeve për mbledhje

Këshilli Bashkiak, që nga konstituimi i tij, ka vazhduar punën normalisht duke u mbledhur të paktën një herë në muaj ose më shumë në varësi të nevojave.

Për periudhën mars 2020 – maj 2021, që është edhe periudha e kufizimeve të lëvizjes për shkak të pandemisë botërore Covid 19, Këshilli Bashkiak i ka realizuar mbledhjet në distancë nëpërmjet programeve të internetit, pra nëpërmjet takimeve online. Diskutimet e Këshillit janë publikuar në rrjetin social facebook të Këshillit Bashkiak. Sipas Rregullores Për Organizimin dhe Funksonimin e Këshillit Bashkiak Pogradec: “Njoftimi për zhvillimin e mbledhjes së Këshillit për këshilltarët dhe qytetarët bëhet, si rregull, jo më pak se 5 ditë para datës së zhvillimit të mbledhjes. Kur në rend të ditës janë çështje, të tilla si: buxheti apo paketa fiskale, njoftimi për këshilltarët duhet të bëhet jo më pak se 10 ditë para datës së mbledhjes.” Kjo dispozitë është zbatuar gjithmonë dhe për trasparencë me qytetarët njoftimet për mbledhjen e Këshillit Bashkiak janë afishuar në Këndin Informativ, i cili ndodhet përpara Bashkisë së Pogradecit.


Nga monitorimet e kryera vihet re se Këshilli Bashkiak Pogradec njofton për mbledhjet e këshillit 5 ditë para zhvillimit të mbledhjes. Njoftimi për projekt-aktet e bëra publike në regjistrin elektronik mund të kryhet edhe në një apo disa nga format e mëposhtme: a. me postë elektronike; b. me lajmërim publik, i cili afishohet në ambientet e hollit të Bashkisë; c. me një lajmërim në mediat audio-vizive vendore; b. me botimin në gazetën bashkiake ose në dy gazetatat më të lexuara në nivel kombëtar. Njoftimi për mbledhjen e këshillit bëhet publik në vende të caktuara për këtë qëllim brenda territorit të njësisë vendore dhe përmban datën, vendin, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes. Të intervistuarit po ashtu kanë pohuar se ky rregull zbatohet plotësisht.



### **Publikimi i akteve**


Neni 18 i ligjit 139/2015 referon në mënyrë të drejtpërdrejtë ligjin 119/2014 teksa përcakton shprehimisht se: “Aktet e këshillit publikohen në faqen zyrtare të internetit dhe afishohen në vende publike, të caktuara nga këshilli me akses të lirë publik, brenda territorit të njësisë vendore dhe, sipas mundësive, këshilli cakton edhe forma të tjera të publikimit të tyre. Informimi i publikut në çdo bashki bëhet në përputhje me ligjin për të drejtën e informimit dhe rregullat e përcaktuara nga vetë këshilli përkatës për këtë qëllim”.

Nga monitorimet e kryera në faqen web të Bashkisë Pogradec janë të publikuara të gjitha Vendimet e Këshillit Bashkiak dhe tek vendime.al.





Të anketuarit janë përgjigjur 50% në faqen zyrtare dhe 50% në vendet publike pranë bashkisë ose me akses publik.




### Njoftimi dhe informimi i publikut


Këshilli Bashkiak Pogradec ka të gjitha burimet e nevojshme për realizimin e njoftimit dhe informimit për publikun. Njoftimi dhe informimi i publikut realizohet sipas formave të ndryshme të komunikimit duke përfshirë këtu mediat sociale, lajmërim publik afishuar në ambientet e bashkisë apo takimet e drejtëpërdrejta me qytetarët.

### Programet e transparencës në Këshillin Bashkiak

Anëtarët e këshillit Bashkiak janë pyetur nëse janë në dijeni për publikimin e programit të transparencës nga Bashkia Pogradec dhe në masën 100% ato janë përgjigjur po. Po ashtu, janë pyetur në lidhje me publikimin e raporteve vjetore për transparencën në procesin e vendimmarrjes dhe 100% e tyre kanë thënë se këshilli bashkiak publikon raporte të tilla. Programet e transparencës ndërtohen dhe publikohen vetëm nga Bashkia Pogradec dhe jo nga Këshilli Bashkiak.



### Trajnimet në lidhje me detyrimet ligjore dhe informimin publik



Për pyetjen: “A kanë marrë trajnime në lidhje me detyrimet ligjore dhe informimin publik?” 50% u shprehën po dhe 50% jo. Por, u shprehën se gjithmonë ka nevoja për trajnime të ndryshme, si psh: trajnime për projekt-vendime, në lidhje me konsultimin publik etj. Trajnimet janë të nevojshme për një performim më të mirë në lidhje me informimet publike duke mësuar më shumë mbi praktikat dhe procedurat e sakta në kryerjen e detyrës.



## 8. Konkluzione

- Procesi i njoftimit, informimit dhe konsultimit publik, vlerësohet nga institucioni i Bashkisë Pogradec dhe Këshillit Bashkiak si një proces shumë i rëndësishëm dhe shumë i nevojshëm me qëllim që të kontribuojë në rritje të transparencës dhe të rrisë pjesëmarrjen në procesin vendimmarrjes së qytetarëve.
- Janë të ngritura strukturat kryesore në bashki të cilat ndihmojnë në informimin e publikut me një përgjegjës për zyrën e informacionit, marrëdhëniet me publikun nga zyra e marrëdhënieve me jashtë dhe marrëdhënien me mediat nga zyrat media dhe publiku si dhe për të drejtën e informimit personi përgjegjës në rolin e koordinatorit të informimit dhe konsultimit publik.
- Bashkia Pogradec i ndërton komunikimet publike me qytetarët me forma të ndryshme si komunikim i drejtëpërdrejtë.
- Pavarësisht arritjeve të deritanishme, realizimi i procesit të konsultimit publik ka ende nevojë për përmirësime. Kjo kërkon rritjen dhe nxitjen e interesit të qytetarëve për të marr pjesë dhe për t'u përfshirë në sa më shumë takime e dëgjesa publike, përfshirë procesin e hartimit të projekt-buxheteve.
- ✓ Bashkia duhet të përditësojë rregullisht mediat në mënyrë që ndikimi dhe informimi tek qytetarët të jetë sa më i madh. Ndërtimi i një plani strategjik komunikimi me mediat do të ndihmonte në targetimin e një grupi sa më të madh të audiencës. Ndërtimi i komunikimit të duhur në këto media siguron informimin, orientimin dhe përfshirjen demokratike të qytetarëve në qeverisjen vendore.
- ✓ Në përputhje edhe me Ligjin 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” Bashkia e ka ndërtuar faqen e vetë zyrtare, një strukturë e mirëfilltë për publikimin e informacioneve që lidhen me institucionin. Por, nga vëzhgimi del që kjo faqe ka nevojë të përditësohet më shpesh në disa fusha.
- Këshilli Bashkiak i zhvillon mbledhjet e hapura dhe një pjesë e mirë e tyre zhvillohen dhe transmetohen online. Mbledhjet njoftohen në faqen zyrtare të facebook-ut të KB, ku përfshihen edhe njoftimi për mbledhjet e komisioneve.

## 9. Rekomandime

- Realizimi i procesit të konsultimit publik ka nevojë të thellë për përmirësime, pasi duhet të nxiten qytetarët të marrin pjesë sa më shumë në diskutime publike dhe jo

vetëm të ftuar apo punonjës të administratës. Gjetja e një mënyrë atraktive për publikun dhe qytetarët është shumë e nevojshme.

- Bashkia Pogradec duhet të strukturojë dhe të bëjë më të lehtë procesin e ankesës dhe kërkesave pasi ka shumë burime dhe opsione për këtë shërbim të vendosura ne seksione të ndryshme të website. Kjo mund të sjellë konfuzion dhe vështirësi për qytetarin në përfundimin e kërkesës së tij.
- Procesi i dixhitalizimit të shumë shërbimeve ka krijuar vështirësi në aksesin e informacionit apo shërbimit për shumë qytetarë. Me qëllim uljen e kostove për qytetarët, bashkia mund të angazhojë burime të veta të trajnuara si në zonën urbane por me fokus në zonën rurale.
- Duhet shtuar trajnimet për stafin mbi informimin publik dhe si të jenë sa më eficient dhe transparent për t'i ardhur në ndihmë qytetarëve.
- Të vendoset opsioni “Search” tek website i Bashkisë Pogradec për lehtësim të kërkimit të informacionit nga qytetarët dhe të interesuarit.

*Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin të qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve, projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga “Olof Palme International Center” dhe “National Endowment for Democracy.” Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:*

- Qendra “Aleanca Gjimore për Zhvillim”, Tiranë;
- Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës;
- Qendra Rinore Vlorë,
- Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Kamëz;
- Epoka e Re, Fier;
- Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër;
- Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë;
- Qendra për Progres Rinor, Kukës,
- Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim, Pogradec;
- Gruaja në Zhvillim, Korçë;
- Hapa të Lehtë, Vau i Dejës;
- Tjetër Vizion, Elbasan